

**KRITERET PËR TË VENDOSUR DEROGIME (KUFIZIME) PER NJESITE
GJENERUESE TE ENERGJISE ELEKTRIKE**

Baza ligjore për vendosjen e Kritereve për Derogime (kufizime) për njesite gjeneruese të energjise elektrike

Në datën 12 Janar 2018, Grupi i Përhershëm i Nivelit të Lartë i Sekretariatit të Komunitetit të Energjise, përshtati vendimet të cilat përfshijnë kodet e lidhjes së rrjetit bazuar në kuadrin ligjor *acquis*) për energjinë elektrike të Komunitetit të Energjisë dhe të Rregullores të Komisionit (KE) 2016/631, (KE) 2016/1388 si dhe (KE) 2016/1447. Për këtë arsye, nxjerrja për transpozim, si dhe për zbatim të kodeve dhe udhëzimeve të rrjetit që dalin nga institucionet Europiane është vendosur si një nga aktivitetet kryesorë të punës së institucioneve përkatëse në Shqipëri. Enti Rregullator i Energjisë (ERE) dhe Operatori të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a) të cilat bazuar në Ligjin nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar janë organet kryesore përgjegjëse për këto aktivitete kanë realizuar transpozimin, zbatimin e kodeve dhe udhëzimeve të rrjetit që kanë dalë nga institucionet Europiane.

Në këtë kontekst, në Qershor 2018, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) miratoi vendimin mbi transpozimin e kodeve të rrjetit për lidhjen (Vendimet nr. 127, 128, 129 datë 04.06.2018) ku përcaktohen kushtet dhe termat që sektori i energjisë elektrike në Shqipëri duhet të transpozojë tre Rregulloret e përmendura të cilat janë miratuar sipas përcaktimeve të kuadrin ligjor të Komunitetit të Energjisë.

Bazuar në kërkesat e Komunitetit të Energjisë në lidhje me afatet për transpozimin dhe zbatimin e dispozitave të Rregullave të përmendura me sipër të cilat janë nxjerrë me përparësi nga Grupi i Përhershëm i Nivelit të Lartë dhe kërkojnë zbatimin në kohë sa më të shpejtë, ERE vijoi punën për miratimin e tyre.

Në përputhje me kompetencat e Entit Rregullator të Energjisë (ERE) të përcaktuara sipas Nenit 63 (1) të Ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar si dhe Vendimit nr. 2018/03/PHLG-EnC të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë datë 12 Janar 2018, ERE me Vendimin e Bordit të Komisionereve nr.129 datë 04.06.2018 miratoi Rregullat e Kodit të Rrjetit për Lidhjen.

Dispozitat që do të zbatohen dhe që janë miratuar nga ERE ndër të tjera përfshijnë Nenin 61(1) të Rregullores së Komisionit (KE) datë 14 Prill 2016 për krijimin e kodit të rrjetit për lidhjen me rrjetin e gjeneruesve të energjisë elektrike janë përshtatur sipas kuadrin ligjor të Komunitetit të Energjisë dhe bazuar në Vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC datë 12 Janar 2018.

Bazuar në këto dispozite të Rregullores së miratuar, Autoriteti rregullator duhet të specifikojë, pasi të konsultohet me operatorët përkatës të sistemit dhe zotëruarit e objektit gjenerues të energjisë elektrike si dhe pjestar të tjerë të tregut të energjisë elektrike të cilët vlerësojnë se mund të preken nga kjo Rregullore, kriteret për vendosjen e derogimeve (kufizimeve) sipas përcaktimeve të Neneve 62 dhe 63 të Rregullores së publikuar nga ENTSO_E.

Vec sa me sipër, dispozita e Nenit 9 të Rregullave mbi Kodin e Rrjetit për Lidhjen specifikon që ERE duhet të veçojë kriteret për dhënien e derogimeve (kufizimeve) nga kërkesat për lidhjen e moduleve të gjenerimit me një vendim të veçantë.

Bazuar ne me siper ERE me kërkesë të:

1. Zoteruesit e njesive gjeneruese te energjise elektrike ne operim,
2. Zoteruesit e njesive gjeneruese te energjise elektrike qe kerkojne te lidhen me sistemin elektroenergjitik;
3. Operatoreve respektiv te rrjetit OST sh.a. dhe OSHEE sh.a.

ERE mund te vendose per aplikimin e derogimeve (kufizimeve) apo per heqen e tyre per pjestaret e tregut te cilet kane tew drejte te kerkojne derogimeve (kufizimeve). Kriteret e veçanta qe do te aplikohen per vendosjen e derogimeve (kufizimeve) do te publikohen në faqen zyrtare të ERE www.ere.gov.al si dhe do të njoftohet Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.

I – Kriteret për të vendosur derogime (kufizime)

Ne rastet kur ERE vendos lidhur me nje kërkesë te paraqitur për derogime (kufizime) nga njesite gjeneruese te lidhura apo qe kerkojne te lidhen me rrjetin elektrike, ERE duhet të marrë në konsideratë rrethanat e meposhtme:

1. Nëse aplikimi i disa ose të gjitha dispozitave të Rregullores së përshtatur të Komisionit (KE) 2016/631 datë 14 Prill 2016 mund të ketë ndonjë efekt negativ në sigurinë e operimit dhe qëndrueshmërinë e sistemit elektroenergjitik,
2. Nëse zoteruesit e njesive gjeneruese te energjise elektrike ne operim ose zoteruesit e njesive gjeneruese te energjise elektrike qe kerkojne te lidhen ne sistemin elektroenergjitk përmbushin disa ose të gjitha kërkesat e Rregullores si dhe nëse ballafaqohen me probleme te justifikueshme teknike ose ekonomike në lidhje me:
 - a) Ilojin e burimit primar të gjenerimit te energjisë elektrike,
 - b) Ilojin e gjeneruesit të sinkronizuar apo jo në sinkronizuar ne sistemin elektroenergjitik.

Kriteret qe do te aplikohen per derogime (kufizime) do te jene transparente dhe jo diskriminuese per te gjithe gjeneruesit egzistues apo ata gjenerues qe kerkojne te lidhen ne sistemin elektroenergjitk. Pavarësisht kësaj, kërkesa për derogime (kufizime) do të refuzohet nëse ka elemente të sjelljes diskriminuese të operatorit përkatës të sistemit në lidhje me rastet identike të lidhjes të moduleve të ngjajshme ose identike të gjenerimit.

II – Rekomandime shtesë për aplikantët

Enti Rregullator i Energjisë (ERE) u rekomandon aplikuesve qe kerkojne derogime (kufizime) se ne lidhje me derogimet (kufizimet) duhet te konsultohen me rekomandimet e dokumentit te Rrjeteve Europiane të Operatorëve të Sistemit të Transmetimit për Energjinë Elektrike (ENTSO-E). Ky dokument është publikuar në faqen e internetit të ENTSO – E, nën seksionin “Kodet e Rrjetit për Lidhjen”. Me poshte adresa elektronike e faqes se ENTSO_E.

https://www.entsoe.eu/network_codes/cnc/cnc-igds/

III – Kërkesat për derogime (kufizime) duhet të plotësohen duke përdorur formularin sipas shtojcave bashkëlidhur:

SHTOJCA 1 – Formular i kërkesës për kufizim nga Zotëuesit e objekteve që gjeneruese të energjise elektrike.

SHTOJCA 2 – Formular i kërkesës për derogim (kufizim) nga operatori i sistemit respektiv.

Dispozitat për të cilat kërkohet kufizimi	
Periudha që propozohet për kohëzgjatjen e kufizimit	Nga Për

IV – Lista e dokumentave

a) Dokumentat bazë

Prova	Të paraqitura (shënoni më poshtë kur është e nevojshme)	
Përshkrimi i moduleve që gjenerojnë fuqi për të cilat kërkohet kufizim	Po	Jo
Përshkrim i detajuar për kufizimin që kërkohet	Po	Jo
Arsyetim i detajuar së bashku me dokumentat mbështetës dhe analizën përfitim-kosto	Po	Jo
Demonstrim që kufizimi i kërkuar nuk ka efekte të kundërta tek tregëtia ndër – kufitare	Po	Jo

b) Dokumenta të tjera

Nr.	Emri i Dokumentit
1.	
2.	
3.	
4.	
5.	

Vendi dhe data ku është plotësuar kërkesa	Vendi: Data:
Emri dhe Mbiemri i personit përgjegjës	
Firma e personit përgjegjës dhe vula	

Formati i kërkesës për kufizime nga operatori përkares i sistemit

I – Të dhëna të përgjithshme për operatorin e sistemit

Emri	
Pozicioni	
Adresa	
Adresa e emailit	
Nr. telefon	
Faks	

II – Personi i kontaktit i operatorit të sistemit

Emri dhe mbiemri	
Pozicioni	
Adresa e email	
Numrat e telefonit	

III – Të dhëna bazë për objektin

Emri	
Lloji i modulit që gjeneron fuqi	
Lloji i burimit primar të energjisë	
Vendndodhja	
Numri i moduleve që gjenerojnë fuqi	
Kapaciteti total i instaluar [kW]	
Tensioni i lidhjes [kV]	
Çertifikata e prodhuesit të pajisjes (shënojeni kur është e nevojshme)	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo
Jetëgjatësia	
Koha e pritshme e vendosjes në punë	
Dispozitat për të cilat kërkohet kufizimi	
Periudha që propozohet për kohëzgjatjen e kufizimit	Nga Në.

IV – Lista e dokumentave

a) Dokumentat bazë

Prova	Të paraqitura (shënojeni kur është e)
Përshkrim i moduleve që gjenerojnë fuqi për të cilat kërkohet kufizim dhe kapaciteti total i instaluar si dhe numri i moduleve që gjenerojnë fuqi	Po Jo <input type="checkbox"/>
Përshkrim i detajuar i kufizimit që kërkohet	Po Jo <input type="checkbox"/>
Arsyetim i detajuar së bashku me dokumentat bashkëlidhur si dhe analiza përfitim kosto	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo
Demonstrim që kufizimi i kërkuar nuk ka efekte të kundërta tek tregëtimi ndër – kufitar	Po Jo

Analiza përfitim – kosto (nëse aplikohet, analiza përfitim kosto kryhet nga operatori I rrjetit respektiv ku është lidhur gjeneruesi (OST sh.a. ose OSHEE)	Po	Jo
--	----	----

b) Dokumenta të tjera

Nr.	Emri i Dokumentit
1.	
2.	
3.	
4.	
5.	

Vendi dhe ora kur është plotësuar kërkesa	Vendi:	Data:
Emri dhe mbiemri i personit përgjegjës		
Firma e personit përgjegjës dhe vula		